

Kërkesë për informacion

Kërkues: T..... H....., [REDACTED]
[REDACTED], me banim në Sarandë, me adresë [REDACTED]
[REDACTED] Sarandë cel : [REDACTED], përfaqësuar me prokurë nga
Av.B [REDACTED] K [REDACTED].

Drejtuar: Drejtorisë së Përgjithshme të Doganave, z.Genti Gazheli, Drejtor i Përgjithshëm,
Email: helpdesk.dpd@dogana.gov.al Tiranë, Kashar Mëzez, Lagjia Fushë Mëzez,
autostrada Tiranë-Durrës, km 1, Qendra "Pajtoni Bussines Center", kati 5.

Objekti: Kërkesë për informacion për hyrjen/ deklarinimin doganor/ importimin e një vessel
Moggaro 700 Jet në shumën [REDACTED] €.

I nderuar, Z. Gazheli

Pala e përfaqësuar prej meje, Z. T [REDACTED] H [REDACTED] në vitin 2022 ka lidhur një kontratë MOGGARO
ALUMINIUM BOATS me Z. SA [REDACTED] [REDACTED], identifikuar me numër
[REDACTED] me adresë të regjistruar në [REDACTED].
MADRID. SPANJE për ndërtimin/ porosinë e vessel Moggaro 700 Jet në shumën [REDACTED] €
(bashkwlidhur kwtu).

Në këtë kohë ai është asistuar nga shtetasi Z. [REDACTED] K [REDACTED], regjistruar Person Fizik me
NIPT [REDACTED], Data e regjistrimit [REDACTED], Agjensi turistike, Udhërrëfyesi turistik dhe
Operator Turistik; Adresë SARANDE Lagjia nr.1, rruga Butrinti, [REDACTED] dhe
SARANDE Varka me emër "L [REDACTED]".

Kjo shumë është paguar e gjitha nga Z.H [REDACTED] siç mund të vërtetohet nga transfertat bankare
(bashkwlidhur kwtu).

Gjatë kësaj periudhe për shkak të një goditje (stroke) Z.H [REDACTED] ka mbetur i paralizuar dhe është në
trajtimit jashtë shtetit. Z.H [REDACTED] gjithashtu është njoftuar se anija ka kaluar nga dogana shqiptare nën
emrin [REDACTED] K [REDACTED], pavarësisht që z.H [REDACTED] është porositësi dhe pronari i vetëm i anijes
dhe nuk ka një dokument dhurimi, blerje apo transferimi për shtetasin K [REDACTED].

Në respektim të nenit 12 të Ligjit 55/2018 i ndryshuar, që parashikon se "Të drejtat dhe detyrimet e
organeve te tjera 1. Gjatë ushtrimit të profesionit të avokatit, çdo institucion i administratës publike, gjykatat,
prokuroritë, gjykatat e arbitrazhit, noterët, përmbaruesit, organet e Policisë së Shtetit, apo çdo ent tjetër publik ose
subjekt privat, janë të detyruara të plotësojnë kërkesat e ligjshme të avokatit në lidhje me: a) **vënien në
dispozicion të avokatit, brenda një afati të arsyeshëm, të informacioneve të kërkuara prej tij, përveç**

A..... L..... C.....

K..... | partners

Adresa: Rruga Brigada VIII,, Tiranë;@yahoo.com; .tel.....

2

rasteve kur parashikohet ndryshe me ligj të veçantë”, Ju kërkohet të na informoni dhe pasqisjen me dokumentacionin përkatës të hyrjes së anijes. Periudha e hyrjes në shtetin shqiptar mund të përkohet me 1 Maj – 30 Shtator 2022.

me respekt

përfaqësuesi me prokurë

firma/vula